

DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

# MENAXHIMI STRATEGJIK I MJEDISIT JETËSOR DHE NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË NIVEL QENDROR

  
ЗАЕДНО ЗА  
КЛИМАТСКА  
АКЦИЈА

DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

# MENAXHIMI STRATEGJIK I MJEDISIT JETËSOR DHE NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË NIVEL QENDROR

## **Botues**

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

## **Autore**

Bojana Bozhinovska Siljanovska

## **Redaktues**

Bojan Trpevski

## **Projekti**

Organizatata civile në veprim për ndryshimet klimatike

## **Implementues**

Qendra për hulumtim dhe informim për mjedisin jetësor "Eko-vest" nga Shkupi, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj (SHMJR) dhe Organizata lidhja e vlerave natyrore dhe njerëzve-CNVP

## **Përkthim nga gjuha maqedonase në shqip nga përkthyesi**

Rexhep Xheladini

## **Dizajn grafik**

Haris Muriq

## **Shkup, 2023**



Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit "Organizatata civile në veprim për klimën", mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim– SIDA. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë ato të autorëve të kësaj analize dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e donatorit dhe të Qeverisë së Suedisë.

SHKURTESAT	1
HYRJE	2
METODOLOGJIA	2
LIGJI MAQEDONISË PËR MENAXHIMIN AFATGJATË TË MJEDISIT JETËSOR	3
ZBATIMI I LEGJISLACIONIT TË MAQEDONISË	6
KONKLUZIONE	9
REKOMANDIME	10

# PËRMBAJTJA

# SHKURTESAT

<b>PVMSH</b>	Program veprimi për menaxhim me shkretëtirëzimin dhe zbutjen e efekteve nga thatësira
<b>BMU</b>	Baza e menaxhimit të ujërave
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>LMJ</b>	Ligji i Mjedisit Jetësor
<b>LKAA</b>	Ligji për Kualitetin e Ajrit të Ambientit
<b>LMM</b>	Ligji për menaxhimin e mbeturinave
<b>ME</b>	Ministria e Ekonomisë
<b>MMJPH</b>	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
<b>PVN</b>	Plan veprimi nacional për mjedisin jetësor
<b>PNEK</b>	Plani nacional i energjisë dhe klimës
<b>PNMAM</b>	Plani nacional për mbrojtjen e ajrit të ambientit
<b>PNNK</b>	Plani nacional për ndryshimet klimatike
<b>PNRGE</b>	Programi nacional për reduktimin gradual të emetimeve të substancave të caktuara ndotëse
<b>PNMSH</b>	Plani nacional për menaxhim me shkretëtirëzimin dhe zbutjen e efekteve nga thatësira
<b>SNU</b>	Strategjia nacionale e ujërave
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>PRSZHE</b>	Programi për realizimin e strategjisë së zhvillimit të energjisë
<b>PMM</b>	Plani për menaxhimin me mbeturina
<b>RM</b>	Republika e Maqedonisë
<b>PRMM</b>	Plani rajonal për menaxhimin me mbeturina
<b>RMV</b>	Republika e Maqedonisë së Veriut
<b>SZHE</b>	Strategjia e zhvillimit të energjisë
<b>SMM</b>	Strategjia për menaxhimin me mbeturina
<b>UNCCD</b>	Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Shkretëtirëzimit

# HYRJE

Mjedisi jetësor përfshinë hapësirën në të cilën jetojnë dhe ekzistojnë të gjithë organizmat e gjalla, përfshirë njerëzit. Jeta dhe funksionimi i njerëzve përfshin përdorimin e mediave të mjedisit jetësor për aktivitete ekonomike ose të tjera, duke krijuar procese dhe produkte që padyshim kanë një ndikim negativ në mjedisin tonë. Mund të themi se qëllimi i ekzistencës sonë është përdorimi racional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore, në mënyrë të tillë që rezultatet e proceseve të tilla të kenë sa më pak ndikim negativ në mjedisin jetësor të përgjithshëm, gjë që do të nënkuptonte edhe uljen e ndikimit negativ në organizma të tjerë (bimë, kafshë, insekte etj.).

Organizimi i njerëzve në shoqëri nënkupton edhe dorëzimin e sovranitetit të shtetit, i cili si konstrukt shoqëror ka detyrimin të kujdeset për përdorimin dhe menaxhimin racional të burimeve natyrore dhe vendos rregulla dhe standarde për të minimizuar ndotjen e mjedisit jetësor.

Sistemi për shfrytëzimin dhe menaxhimin e mjedisit jetësor në shoqërinë e Maqedonisë është i rregulluar me Kushtetutë dhe me akte të shumta ligjore dhe nënligjore nga fusha e mjedisit jetësor. Legjislacioni rregullon disa dokumente dhe plane strategjike, në nivel qendror, që synojnë planifikimin dhe menaxhimin afatgjatë të burimeve natyrore dhe minimizimin e pasojave negative.

Ky dokument analizon zbatimin e menaxhimit strategjik afatgjatë të burimeve natyrore dhe menaxhimit të ndryshimeve klimatike në nivel qendror.

# METODOLOGJIA

Punimi synon të arrijë objektivat e mëposhtme kërkimore:

- **Të identifikojë dokumentet më të rëndësishme strategjike (strategjitë dhe planet) për menaxhimin afatgjatë të mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike;**
- **Të identifikojë shkallën e zbatimit të legjislacionit për menaxhimin afatgjatë të mjedisit nga aspekti formal dhe përmbajtësor;**
- **Të identifikojë mangësitë në zbatimin e legjislacionit.**

Qasja metodologjike në përgatitjen e dokumentit përfshin zbatimin e metodave të mëposhtme të hulumtimit:

- **Hulumtim nga zyra** – konsultim të legjislacionit përkatës nacional në lidhje me vendosjen e menaxhimit afatgjatë të mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike;
- **Kërkesat për qasje të lirë në informacionin me karakter publik** – duke përdorur instrumentin për qasje të lirë në informacionin me karakter publik për të mbledhur informacionin përkatës.

Dokumenti mbulon periudhën nga viti 2016 deri në mars 2023.

# LIGJI I MAQEDONISË PËR MENAXHIMIN AFATGJATË TË MJEDISIT JETËSOR

- > Ligji për Mjedisin Jetësor është ligji bazë i fushës dhe vendos themelet për mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit jetësor. Ky ligj përcakton dokumentet strategjike/planifikuese të mëposhtme:
  - > **Plan veprimi nacional për mjedisin jetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut<sup>1</sup>** – Qeveria, me propozim të MMJPH-së, miraton PVN-në, i cili është i vlefshëm për 6 vjet. Nëse kushtet ndryshojnë gjatë këtyre 6 viteve, ai duhet të ripërtërihet. Përmbajtja e PVN-së rregullohet me ligj. Çdo 3 vjet, MMJPH-ja i paraqet Qeverisë një raport për zbatimin e të njëjtit;
  - > **Plani nacional për ndryshimet klimatike<sup>2</sup>** – Qeveria, me propozim të MMJPH-së, miraton PNNK-në, i cili ka një periudhë vlefshmërie prej 6 vitesh. Përmbajtja e PNNK-së përcaktohet me ligj dhe përpilohet në përputhje me dokumentet e miratuara të Konventës Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike. MMJPH-ja e informon Qeverinë së paku një herë në 3 vjet për zbatimin e PNNK-së. Përmbajtja e PNNK-së përfshin edhe:
    - > **Inventarizimin nacional të emetimeve antropogjene sipas burimeve dhe vendlëshimeve të gazrave serë<sup>3</sup>**, i cili përgatitet në përputhje me dokumentet e miratuara nga Konventa Kornizë e OKB-së për Ndryshimet Klimatike dhe përgatitet një herë në 3 vjet;
    - > **Plan veprimi për parandalimin e shkaqeve dhe zbutjen e efekteve negative të ndryshimeve klimatike<sup>4</sup>**, i cili ka përmbajtje të rregulluar me ligj dhe miratohet nga Qeveria, me propozimin e MMJPH-së dhe përditësohet sipas nevojës, të paktën çdo 3 vjet;
    - > **Plani nacional për menaxhim me shkretëtirëzimin dhe zbutjen e efekteve nga thatësira<sup>5</sup>** - Qeveria me propozim të MMJPH-së miraton PNMSH-në me vlefshmëri kohore 6 vjet. Përmbajtja është e rregulluar ligj dhe është përpiluar në përputhje me dokumentet e miratuara të Sekretariatit të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Shkretëtirëzimit. MMJPH-ja, në pajtim me MBPEU-në, të paktën një herë në 3 vjet paraqet raport në Qeveri për zbatimin e PNMSH-së. Plani përmban:
      - > **Program veprimi për menaxhim me shkretëtirëzimin dhe zbutjen e efekteve nga thatësira<sup>6</sup>**, ka përmbajtje të rregulluar me ligj dhe miratohet nga Qeveria, me propozimin e MMJPH-së, në pajtim me MBPEU-në dhe përditësohet të paktën çdo 3 vjet.

<sup>1</sup> Ligji i Mjedisit Jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 53/2005; 81/2005; 24/2007; 159/2008; 83/2009; 48/2010; 124/2010; 51/2011; 123/2012; 93/2013; 187/2013; 42/2014; 44/2015; 129/2015; 192/2015; 39/2016 dhe 99/2018 dhe ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 89/2022 171/2022), neni 60, 62 dhe 63

<sup>2</sup> Ibid, nenet 187 dhe 190

<sup>3</sup> Ibid, neni 188

<sup>4</sup> Ibid, neni 189

<sup>5</sup> Ibid, neni 191 dhe 193

<sup>6</sup> Ibid, neni 192

- › Energjia është pjesë e pandashme me ndryshimet klimatike. Duke pasur parasysh këtë, Ligji për Energjinë përcakton:
  - › **Strategjia e zhvillimit të energjisë<sup>7</sup>** - ka përmbajtje të përcaktuar me ligj dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë së Ekonomisë, sillet çdo 5 vjet dhe me projeksion për periudhë 20 vjeçare;
  - › **Programi për realizimin e strategjisë së zhvillimit të energjisë<sup>8</sup>** - ka përmbajtje të përcaktuar me ligj dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë së Ekonomisë, për një periudhë 5-vjeçare. PRSZHE-ja duhet të jetë në përputhje me detyrimet e shtetit me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe ME-ja i dorëzon Qeverisë raport vjetor për zbatimin;
  - › **Plani nacional i energjisë dhe klimës<sup>9</sup>** - ka përmbajtje të rregulluar me ligj dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të ME-së, për një periudhë së paku 10 vjet me projeksion për 20 vjet shtesë. ME-ja dhe MMJPH-ja përgatisin raport mbi zbatimin e PNEK-ut çdo 2 vjet dhe ia dorëzojnë Qeverisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Nëse zbatimi nuk është në përputhje me dinamikën e trajektores treguese, Qeveria do të miratojë një PNEK-ë të rishikuar jo më vonë se 31 mars i vitit pasardhës.
- › Uji është burim natyror i rëndësishëm për ekosistemet dhe shoqëritë, në përgjithësi, prandaj Ligji për Ujërat, si ligj bazë që trajton menaxhimin dhe përdorimin e ujërave, përcakton:
  - › **Strategjinë nacionale të ujërave<sup>10</sup>** - ka përmbajtje të rregulluar me ligj dhe sillet nga Kuvendi, me propozim të Qeverisë dhe vlen për një periudhë 30 vjeçare;
  - › **Bazën e menaxhimit të ujërave të Republikës së Maqedonisë<sup>11</sup>** - ka përmbajtje të rregulluar me ligj dhe sillet nga Kuvendi, me propozim të Qeverisë, me qëllim të zbatimit të SNU-së. Baza për menaxhimin e ujërave kryhet për një periudhë prej 20 vjetësh dhe rishikohet, ndryshohet dhe/ose plotësohet detyrimisht çdo 10 vjet dhe më herët nëse është e nevojshme.
- › Mbeturinat janë një sfidë serioze në Maqedoninë e Veriut dhe janë të lidhura me ndryshimet klimatike, kështu që Ligji për menaxhimin e mbeturinave<sup>12</sup> si ligj i përgjithshëm i kësaj fushe e përcakton:
  - › **Strategjinë për menaxhimin me mbeturina** – që miratohet nga Qeveria me propozim të MMJPH-së dhe zbatohet për një periudhë 12-vjeçare. Dy ligjet përcaktojnë përmbajtje të ndryshme të SMM-së dhe ligji aktual përcakton që duhet të rishikohet pas 6 vjetësh;
  - › **Planin për menaxhimin me mbeturina në Republikë** – e sjell MMJPH-ja me qëllim të zbatimit të SMM-së. Dallimet midis dy ligjeve lidhen me periudhën kohore të vlefshmërisë, përmbajtjen, kohëzgjatjen e raporteve të monitorimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre në Qeveri;<sup>14</sup>

<sup>7</sup> Ligji për Energjinë ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 96/2018 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 96/2019 dhe 236/2022), neni 11

<sup>8</sup> Ibid, neni 12

<sup>9</sup> Ibid, neni 172

<sup>10</sup> Ligji për ujërat ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 87/2008, 6/2009, 161/2009, 83/2010, 51/2011, 44/2012, 23/2013, 163/2013, 180/2014, 146/2015 и 52/2016 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 151/2021), neni 62

<sup>11</sup> Ibid, nenet 63-65

<sup>12</sup> Në periudhën e hulumtimit, janë në fuqi dy ligje për menaxhimin e mbetjeve, të cilat në përgjithësi përcaktojnë të njëjtat lloje të dokumenteve strategjike: Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 68/2004, 107/2007, 102/2008, 143/2008, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 147/2013, 163/2013, 51/2015, 146/2015, 156/2015, 192/2015, 39/2016, 63/2016 и 31/2020) dhe Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 216/2021)

<sup>13</sup> Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 68/2004, 107/2007, 102/2008, 143/2008, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 147/2013, 163/2013, 51/2015, 146/2015, 156/2015, 192/2015, 39/2016, 63/2016 и 31/2020), neni 16 paragrafi 2 Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 216/2021), neni 22 paragrafi 2

<sup>14</sup> Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 68/2004, 107/2007, 102/2008, 143/2008, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 147/2013, 163/2013, 51/2015, 146/2015, 156/2015, 192/2015, 39/2016, 63/2016 и 31/2020), neni 17 Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 216/2021), neni 23

- > **Planet rajonale për menaxhimin me mbeturina** – miratohen nga komunitet, me propozimin e bordeve ndërkomunale të menaxhimit të mbeturinave dhe pas aproimit nga MMJPH-ja. Dallimet mes dy ligjeve i referohen kryesisht periudhës kohore të vlefshmërisë, përmbajtjes, kohëzgjatjes së raporteve të monitorimit dhe mënyrës së dorëzimit të tyre në komuna;<sup>15</sup>
- > **Plani për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave<sup>16</sup>** - paraqet një risi në raport me ligjin e mëparshëm. Plani miratohet nga MMJPH-ja për një periudhë 6-vjeçare dhe nuk ka përmbajtje të saktë, por të përcaktuar në mënyrë përshkruese, si dhe mund të ndryshohet çdo 3 vjet me propozim të Administratës së Mjedisit Jetësor.
- > Ajri është mediumi për të cilin shteti ballafaqohet vazhdimisht me sfida, andaj Ligji për Kualitetin e Ajrit të Ambientit, si ligj bazë në këtë fushë, përcakton:
  - > **Planin nacional për mbrojtjen e ajrit të ambientit në Republikën e Maqedonisë së Veriut<sup>17</sup>** - miratohet nga Qeveria, me propozim të MMJPH-së dhe zbatohet për të paktën 5 vjet, si dhe MMJPH-ja njofton Qeverinë për zbatimin çdo 2 vjet. Përmbajtja dhe mënyra e përpilimit janë të rregulluara me ligj;
  - > **Programi nacional për reduktimin gradual të emetimeve të substancave të caktuara ndotëse<sup>18</sup>** - miratohet nga Qeveria, me propozim të MMJPH-së dhe nuk ka përmbajtje të saktë, por të përcaktuar në mënyrë përshkruese, por është interesant se nuk është përcaktuar periudha për të cilën është miratuar dhe nuk ka një angazhim të saktë kohor për përditësimin e tij.

<sup>15</sup> Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 68/2004, 107/2007, 102/2008, 143/2008, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 147/2013, 163/2013, 51/2015, 146/2015, 156/2015, 192/2015, 39/2016, 63/2016 и 31/2020), neni 18-a Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 216/2021), neni 24

<sup>16</sup> Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 216/2021), neni 25

<sup>17</sup> Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 67/2004, 92/2007, 35/2010, 47/2011, 59/2012, 163/2013, 10/2015 и 146/2015 dhe ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 151/2021), neni 25

<sup>18</sup> Ibid, neni 27-b dhe 27-c



# ZBATIMI I LEGJISLACIONIT TË MAQEDONISË

Nëpërmjet semaforit të përputhshmërisë, ky kapitull do të ofrojë të dhëna për shkallën e zbatimit të legjislacionit të Maqedonisë për menaxhimin strategjik të mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike. Vlerësimi i dokumenteve bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:

1. Dokumenti ka vlefshmëri të përshtatshme kohore:
  - a. Kohëzgjatja e dokumentit korrespondon me kohëzgjatjen ligjore;
  - b. Organi/autoriteti ka sjellë dokumente për të gjithë periudhën e hulumtimit;
2. Përmbajtja e dokumentit korrespondon me rregullimin ligjor:
  - a. Dokumenti përmban plotësisht përmbajtjen e përcaktuar në ligj/mbulon plotësisht temat e përcaktuara në ligj;
  - b. Dokumenti përmban masa (nëse është e aplikueshme);
    - i. Masat kanë afat të kufizuar kohorë

DOKUMENTET STRATEGJIKE NË NIVEL NACIONAL				
Emri i dokumentit	I miratuar	I ndryshuar	Monitorimi	Shënim
<b>Plan veprimi nacional për mjedisin jetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut</b>				PVN-ja e fundit është miratuar për periudhën 2006-2012. MMJPH-ja thekson se pas vitit 2012 është miratuar Strategjia e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike 2014-2020, por aktualisht ajo ka skaduar. Strategjia e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike nuk është e rregulluar në mënyrë eksplicite në legjislacionin e Maqedonisë.
<b>Plani nacional për ndryshimet klimatike</b>				Shteti ka përpiluar katër (4) PNNK-ja, por pas viteve kur janë sjellë, mund të konstatohet se nuk hartohen rregullisht (PNNK 3 është sjell në vitin 2014, ndërsa PNNK 4 është sjell në vitin 2023). Nga një kërkim në ueb faqen e Qeverisë nuk mund të përcaktohet saktësisht se kur janë miratuar këto dy PNNK-ë. Për sa i përket përmbajtjes, subjektivisht, duke mos hyrë në ekspertizën e të dhënave, PNNK 4 është më i strukturuar dhe vërehet një rritje në vëllim, si dhe në planin e veprimit dhe cilësinë e paraqitjes së të dhënave në raport me PNNK 3. Të dy planet pothuajse në tërësi ndjekin përmbajtjen e neneve 187 dhe 189 të LMJ-së, por në PNNK 3 është e paqartë nëse ka fare analizë ekonomike, sepse disa nga masat nuk kanë strukturë financiare. Në të dy planet, plani i veprimit është i përfaqësuar në pjesë të ndryshme dhe nuk është e vetmja përmbajtje, por ndryshe nga PNNK 4, në PNNK 3 një numër i madh i masave nuk kanë konstruksion financiar, kufizim kohor dhe subjekte të përcaktuara saktë përgjegjëse për zbatim. Nga shikimi i ueb faqes <a href="http://www.klimatskipromeni.mk">www.klimatskipromeni.mk</a> dhe <a href="http://www.vlada.mk">www.vlada.mk</a> nuk ka ndryshime në Planin e Veprimit (neni 189 paragrafi 4 i LMJ-së) apo inventar të ri (neni 188 paragrafi 4 i LMJ-së), as raportet trevjeçare të referuara në nenin 190 të LMJ-së.

<p><b>Plani nacional për menaxhim me shkretëtirëzimin dhe zbutjen e efekteve nga thatësira</b></p>		<p>///</p>	<p>Asnjë PNMSH nuk është miratuar për të gjithë periudhën e hulumtuar (draft PNMSH-ja është përgatitur në vitin 2017, por për shkak të kërkesave të marra nga Sekretariati i UNCCD. MMJPH-ja planifikon që në periudhën e ardhshme të auditojë PNMSH-në dhe PVMSH-në sipas kërkesave nga Sekretariati dhe të dorëzojë tekstet përfundimtare për miratim nga Qeveria e RMV-së); PNMSH-ja dhe PVMSH-ja ndjekin plotësisht përmbajtjen e neneve 191 dhe 192 të të LMJ-së, por megjithëse është bërë një analizë dhe vlerësim i burimeve të financimit të masave të parashikuara, nuk është e qartë nëse është dhënë një vlerësim i saktë i financave për secilën masë veçmas. MMJPH-ja do t'i qaset ndryshimit dhe plotësimit të LMJ-së për përcaktimin e përmbajtjes së PNMSH-së dhe harmonizimin e plotë të legjisllacionit maqedonas me kornizën e re strategjike të UNCCD-së.</p>
<p><b>Strategjia e zhvillimit të energjisë</b></p>		<p>///</p>	<p>///</p> <p>Në vitin 2010 është miratuar SMM-ja deri në vitin 2030 dhe në vitin 2020 është miratuar SMM-ja deri në vitin 2040. Dokumentet ndjekin përmbajtjen e Ligjit për Energjinë që ishte i vlefshëm në kohën e përpilimit dhe miratimit të tyre.</p>
<p><b>Programi për realizimin e strategjisë së zhvillimit të energjisë</b></p>		<p>///</p>	<p>Për periudhën e hulumtuar janë miratuar vetëm një program (PRSZHE 2013-2017). Në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë është publikuar, drafti i PRSZHE 2021-2025 por në përgjigjen e marrë nga ME nuk rezulton se është miratuar. Programet korrespondojnë me kohëzgjatjen e përcaktuar me ligj dhe ndjekin përmbajtjen e përcaktuar nga Ligji për Energjinë që ishte i vlefshëm në kohën e hartimit të tyre. PRSZHE-të nuk janë miratuar në kohë, gjegjësisht për SZHE-në deri në vitin 2030, PRSZHE-ja duhet të ishte miratuar deri në vitin 2011, por është miratuar në vitin 2013, ndërsa SZHE-ja deri në vitin 2040, edhe pse është përgatitur një draft PRSZHE, rezulton se ai nuk është miratuar. Në të njëjtën kohë, nuk ka PRSZHE për periudhën 2018-2020. Gjatë periudhës së hulumtimit është përgatitur një raport për realizimin e PRSZHE 2013-2017, për periudhën deri në korrik 2016. Raporti shpjegon për faktin se projektet energjetike janë afatgjate, efektet e rëndësishme nuk mund të arrihen në një periudhë raportuese njëvjeçare.</p>
<p><b>Plani nacional i energjisë dhe klimës</b></p>			<p>Më 31.5.2022, në seancën e 49-të, Qeveria miratoi PNEK 2022-2032. Në kohën e miratimit të PNEK-ut, legjisllacioni i Maqedonisë nuk parasheh një dokument të tillë strategjik, por kjo është bërë me ndryshimet në Ligjin për Energjinë nga nëntori i vitit 2022. Ndonëse është miratuar në seancën e 49-të të Qeverisë më 31.5.2022, PNEK –u 2022-2032 nuk është publikuar në "Gazetën Zyrtare", për të cilën i referohet Ligji për Energjinë. Për të gjitha këto arsye, nuk mund të konsiderohet se PNEK-u i miratuar 2022-2032 prodhon efekt juridik, prandaj në këtë dokument konsiderohet se detyrimi për miratimin e PNEK-së ende nuk është përmbushur. Edhe nëse konsiderohet se PNEK 2022-2032 është miratuar dhe publikuar në përputhje me rrethanat, afatet e raportimit për zbatimin e tij dhe ndoshta modifikimin e tij nuk do të kishin kaluar, kështu që ato aspekte nuk mund të analizohen në këtë dokument.</p>
<p><b>Strategjia nacionale e ujërave</b></p>		<p>///</p>	<p>///</p> <p>Ky dokument nuk përfshinë synime dhe prioritetet specifike strategjike investimi, as masa dhe aktivitete për zbatimin e tyre. Strategjia e ujërave nuk e përcakton politikën afatgjate për menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe nuk ofron zgjidhje teknike dhe ekonomike për çështjet e ndryshme të ujit dhe afatin kohor për realizimin e tyre.<sup>19</sup></p>

<sup>19</sup> Raporti i parë në hije për kapitullin 27 Republika e Maqedonisë së Veriut 2021, Qendra për Ndryshimet Klimatike, në dispozicion në: [https://drive.google.com/file/d/1z\\_O\\_oKUwV-LWaadXtprNCGIziFW4j-8Y/view](https://drive.google.com/file/d/1z_O_oKUwV-LWaadXtprNCGIziFW4j-8Y/view)

Raporti në hije për kapitullin 27 Republika e Maqedonisë së Veriut 2021, Qendra për Ndryshimet Klimatike, në dispozicion në: <https://fosh.mk/wp-content/uploads/2023/01/final-shadow-report-mkd-22.pdf>

<b>Baza e menaxhimit të ujërave të Republikës së Maqedonisë</b>				
<b>Strategjia për menaxhimin me mbeturina</b>		///	///	Është miratuar Strategjia e menaxhimit të mbeturinave 2008-2020 dhe Strategjia e re do të fillojë të përgatitet në gjysmën e dytë të vitit 2023 në kuadër të një projekti të financuar nga BE. SMM 2008-2020 përmban plotësisht temat nga neni 16 i LMM-së i cili ishte i vlefshëm në kohën e hartimit të dokumentit.
<b>Plani rajonal për menaxhimin me mbeturina</b>				Në periudhën e hulumtuar ekziston vetëm PMM-ja 2021-2031, ndërsa vlefshmëria e PMM-së së mëparshme ka skaduar në vitin 2015. PMM-ja 2021-2031 përmban plotësisht temat nga neni 17 i LMM-së i cili ishte i vlefshëm në kohën e përgatitjes së dokumentit. Nuk është e mundur të analizohet nëse PMM-ja po ndiqet siç duhet sepse PMM-ja e mëparshme tashmë ka skaduar në periudhën e hulumtimit, ndërsa afati për përgatitjen e raportit të parë për PMM-në 2021-2031 nuk ka kaluar ende.
<b>Plani rajonal për menaxhimin me mbeturina</b>		///		Planet rajonale janë miratuar për të gjitha rajonet e vendit dhe të gjitha ato respektojnë plotësisht përmbajtjen e Rregullores për përmbajtjen e planit rajonal të menaxhimit të mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 63/2013), por PRMM-ja për rajonin juglindor është miratuar në vitin 2017, ndërsa PRMM-ja për rajonin e Pollogut është miratuar në vitin 2020. Përgjigjja e marrë nga MMJPH-ja nuk tregon se PRMM-të e tjera kanë ekzistuar më parë për këto dy rajone. Monitorimi i zbatimit të PRMM-së mungon. Në disa rajone, sipas LMM-së nuk është krijuar fare një bord ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave, disa nga komunat nuk kanë fare informacion se është miratuar një PRMM-në për rajonin e tyre, as nuk janë ftuar të marrin pjesë dhe të japin komente gjatë përgatitjes së tyre, e në disa komuna i quajnë paqartësi se kush duhet të monitorojë zbatimin e PRMM-së duke qenë se plani i shtetit është bashkimi i disa rajoneve në drejtim të menaxhimit rajonal të mbetjeve (në mënyrë që dy rajone të kenë vetëm një vend-depozitim rajonal)
<b>Plani për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave</b>			///	Plani për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave është miratuar në vitin 2022 dhe ende nuk janë plotësuar kushtet ligjore për ndryshim.
<b>Plani nacional për mbrojtjen e ajrit të ambientit në Republikën e Maqedonisë së Veriut</b>				PNMAM-ja është miratuar për periudhën 2013-2018 me kohëzgjatje përkatëse sipas LKAA-së dhe PNRGE-së është miratuar për periudhën 2012-2020. Dokumentet në pjesën më të madhe ndjekin përmbajtjen e përcaktuar nga LKAA-ja. Dokumentet e reja strategjike nga fusha e ajrit janë planifikuar të përgatiten në kuadër të një projekti të financuar nga BE-ja. Që nga viti 2020, një proces i përzgjedhjes së kontraktorit është anuluar deri më tani (prill 2022), kështu që MMJPH-ja po punon për shpalljen e një prokurimi të ri publik.
<b>Programi nacional për reduktimin gradual të emetimeve të substancave të caktuara ndotëse</b>				

# KONKLUSIONE

Megjithëse legjislacioni vendos një sistem të menaxhimit strategjik të sektorëve të mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike, mund të thuhet se ende nuk kemi një sistem funksional të menaxhimit strategjik.

Për shembull:

- i. Zbatimi i SMM 2008-2020 ishte menduar të bëhej përmes PMM-së, por PMM-i i fundit ishte i vlefshëm deri në vitin 2015 dhe një i ri nuk u miratua deri në vitin 2021;
- ii. Kohëzgjatja e PMM 2009-2015 është në kundërshtim me vlefshmërinë kohore të përcaktuar nga LMM-ja, i cili ishte i vlefshëm në kohën e miratimit të dokumentit;
- iii. Baza e planeve rajonale për menaxhimin e mbetjeve janë SMM-ja dhe PMM-ja, por kur planet rajonale u miratuan në 2016, 2017 dhe 2020, vlefshmëria e PMM 2009-2015 kishte skaduar tashmë;
- iv. Planet rajonale të menaxhimit të mbeturinave nuk janë miratuar në kohën e duhur dhe zbatimi i tyre nuk monitorohet.

LMJ-ja vendos një sistem të qartë për menaxhimin strategjik të ndryshimeve klimatike, në praktikë është i ndërlikuar dhe i paqartë sepse:

- i. Legjislacioni i Maqedonisë harton vetëm PNNK-në dhe PNEK-në, por në praktikë funksionojnë edhe:
  - a. raportet që shteti i paraqet OKB-së në përputhje me Konventën Kornizë për Ndryshimet Klimatike,
  - b. deri në vitin 2020 ka ekzistuar Strategjia për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike, e cila nuk është e rregulluar me legjislacion, dhe
  - c. Strategjia afatgjate për veprimin klimatik me planin veprimit, e cila është paraqitur me Ligjin për Veprimin Klimatik, i cili ende nuk është miratuar nga Kuvendi;
- ii. Nuk ka raporte për monitorimin e zbatimit të PNNK-së;
- iii. Në përmbajtjen e PNNK 3 i referohet raportit të dytë dhe të tretë që shteti i ka dorëzuar në OKB, kështu që krijohet përshtypja se këto raporte kanë primatin në raport me PNNK-në.

Në PNNK 3, disa herë theksohen të dhëna të pamjaftueshme dhe joadekuate që disponon shteti.

# REKOMANDIME

- › MMJPH-ja tashmë ka vënë në dukje se është e nevojshme të rriten kapacitetet e Drejtorisë së Ujërave<sup>20</sup> pranë Administratës së Mjedisit Jetësor në MMJPH-ja, por situata e përshkruar më sipër tregon nevojën për një analizë funksionale në MMJPH-ja dhe rritje të kapaciteteve edhe të sektorëve të tjerë.
  - › Ndryshime të tilla duhet të kontribuojnë në një zbatim më të mirë të legjislacionit për hartimin, ndryshimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve strategjike në fushën e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike.
  - › Shteti duhet të krijojë një sistem të përhershëm, sistematik, efikas dhe të besueshëm të grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave.
  - › Detyrimet e marra me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare duhet të përmbushen, por kjo nuk duhet të jetë në dëm të mekanizmave të vendosur nga legjislacioni vendas.
  - › Shteti duhet të mendojë nëse duhet të ndryshojë legjislacionin vendor dhe t'i respektojë obligimet që shteti i ka sipas të drejtës ndërkombëtare, në mënyrë që të mos dyfishohen dokumentet që rregullojnë të njëjtën temë, por me kohëzgjatje dhe përmbajtje të ndryshme.
- › Qeveria dhe Kuvendi duhet të jenë më efikas në hartimin, përkatësisht në miratimin e ligjeve, siç është Ligji për Veprimin Klimatik, i cili do të pengonte miratimin e një dokumenti strategjik para se të miratohet baza ligjore për miratimin e tij. Ndryshime të tilla duhet të kontribuojnë pozitivisht në sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike.

<sup>20</sup> Kapacitetet institucionale të Sektorit të Ujërave për Menaxhimin dhe Mbrojtjen e Ujërave, Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë, 2022, në dispozicion në: [https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2022/12/Zastita-na-vodite\\_WEB.pdf](https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2022/12/Zastita-na-vodite_WEB.pdf)

